

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**

---

AA.nr. 54-2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët, Beshir Islami, kryetar i kolegjit, Ragip Namani dhe Nenad Llaziq, anëtar, duke vendosur sipas ankesës së paraqitur nga i dënuari A.R., me vendbanim në fshatin ...., Komuna e D., kundër aktvendimit të Panelit për Lirim me Kusht, PLK.D.nr...., të datës 09.12.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë, 14.01.2025, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

Hedhet si e pa lejuar, ankesa e paraqitur nga i dënuari A. R., me vendbanim në fshatin ..., Komuna e D., kundër aktvendimit të Panelit për lirim me kusht, PLK.D.nr...., të datës 09.12.2024.

**A r s y e t i m**

Me aktvendimin e Panelit për Lirim me Kusht, PLK.D.nr...., të datës 09.12.2024, ishte vendosur në pikën të dispozitivit të refuzohet kërkesa për lirim me kusht e të dënuarit A.R. nga i ati H. dhe e ëma B., e gjinisë S., i lindur me datë ....., në fshatin ..., Komuna D., ku edhe e ka vendbanimin, me nr. personal ....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës. Në pikën II të dispozitivit të vendimit ishte vendosur që kërkesa për lirim me kusht i refuzohet për periudhën kohore prej 12 muaj, e njëjta mund të rishqyrtohet pas kalimit të këtij afati..

Kundër aktvendimit të lartë përmendur, i dënuari A. R., me kohë ka parashtruar ankesë për shkak të zbatimit të gabuar të Ligjit, me pretendim se i ka plotësuar kushtet ligjore për lirim me kusht, andaj propozon që kërkesa e tij për lirim me kusht të aprovohet si e bazuar.

Paneli për Lirim me Kusht, me përgjigjen në ankesë, ka kontestuar lejueshmërinë e një ankesë të tillë të paraqitur nga i dënuari, me propozim që e njëjta ankesë të hedhet si e pa lejuar.

Kolegji i Gjykatës Supreme të Kosovës i formuar në pajtim me nenin 117, paragrafi 11, të Ligjit nr.08/L-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, shqyrtoi lejueshmërinë e paraqitjes së ankesës së të dënuarit Atdhetar Rexhepi, dhe gjeti se :

Ankesa është e pa lejuar

I dënuari A. R., ka parashtruar kërkesë për lirim me kusht në pajtim me dispozitat e Ligji i ri për ekzekutimin e sanksioneve penale, Nr.08/L-132 dhe në afatin e paraparë me këtë ligj. Gjykata Supreme e Kosovës duke e shqyrtuar ankesën e të dënuarit dhe pretendimet ankimore shqyrtoi edhe dhe përgjigjen e Panelit për Lirim me Kusht gjeti se:

Paneli për Lirim me Kusht e konsideron ankesën si të palejuar, pasi që me Ligjin (Nr.08/L-132), për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 117, par.8 është paraparë se "Pala e pakënaqur me vendimin e Panelit për Lirim me Kusht, ka të drejtë të ankohet ndaj vendimeve, drejtpërdrejt në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit të vendimit", por njëkohësisht në par.16 po të njëjtit nen ka cekur se "Dispozitat e këtij neni nuk vlejné për rastet kur Paneli për Lirim me Kusht e shtynë rastin për rishqyrtim nga gjashtë (6) muaj e tutje", andaj pas që refuzim për parashtruesin e ankesës ka qenë për dymbëdhjetë (12) muaj, i njëjti nuk ka të drejtë ankesë e po ashtu i njëjti ka qenë i njoftuar edhe përmes Këshillës Juridike se ndaj vendimit nuk ka të drejtë ankesë.

Gjykata Supreme e Kosovës në tërësi e aprovon qëndrimin e Panelit për Lirim me Kusht dhënë në përgjigjen ndaj ankesës dhe gjeti se janë zbatuar drejtë dispozitat e nenit 117, paragrafi 16, i Ligjit (Nr.08/L-132) për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, kur nuk i është lejuar ankesa kur Paneli për Lirim me Kusht e shtynë rastin për rishqyrtim nga gjashtë (6) muaj e tutje pala e pakënaqur nuk mund të ushtoi ankesë. Prandaj edhe Gjykata Supreme e Kosovës, e hedh si të pa lejuar ankesën e të dënuarit duke aprovuar në tërësi qëndrimin e Panelit për Lirim me Kusht, dhënë në këshillën juridike dhe në përgjigjen e datës 23.12.2024.

Duke u bazuar në pa lejueshmërinë e ankesës së të dënuarit, Gjykata Supreme e Kosovës nuk i shqyrtoi fare meritat e ankesës së paraqitur.

Për arsyet e paraqitura më lartë dhe në pajtim me nenin 117 paragrafi 11, 12 dhe 16, Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale Nr.08/L-132, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

A.A.nr.54/2024, datë 14.01.2024

Kryetari i kolegjit

Beshir Islami